

Titulli i lëndës: Menaxhmenti i organizatave publike dhe jofitimprurëse

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Menaxhment
Titulli i lëndës:	Menaxhmenti i organizatave publike dhe jofitimprurëse
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti i tretë (Semestri V)
Numri i orëve në javë:	2+1
Kreditë ECTS:	4 ECTS
Koha/Vendi:	Fakulteti Ekonomik
Mësimdhënësi:	Albana Berisha Qehaja
Të dhënat kontaktuese:	albana.berisha@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Lënda do të fokusohet në ligjërimet e dimensioneve konceptuale dhe empirike të menaxhimit, konceptet dhe parimet bashkëkohore të menaxhimit në organizatat publike, organizmit dhe funksionimit të organizatave jofitimprurëse, politikave, planifikimit strategjik dhe vendimmarrjes, menaxhimit të burimeve njerëzore, menaxhimit të financave dhe buxhetit, mbikëqyrjes dhe kontrollit të organizatave publike dhe jofitimprurëse, sigurimi i fondeve për organizatat jofitimprurëse si dhe kuadri ligjor dhe ai fiskal që rregullon veprimtarinë e sektorit jofitimprurës.
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i kësaj lëndë është që studentët të njohohen më menaxhimin e organizatave publike dhe jofitimprurëse, gjenezën dhe përkufizimin e tyre, si dhe më parimet themelore në të cilat do të bazohet puna e secilit menaxher të ardhshëm.</p> <p>Ndjekja e kësaj lënde ka për qëllim që studentët të përfitojnë njohuri themelore për modelet e menaxhimit publik, shërbimeve publike, planifikimin strategjik në organizatat publike dhe jofitimprurëse, organizimi dhe funksionimi i organizatave publike dhe jofitimprurëse, zhvillimi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i vullnetarëve, mbikëqyrja dhe kontrolli i organizatave publike dhe jofitimprurëse.</p> <p>Të mësuarit e kësaj lënde studentëve do t'u mundësojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të mësojnë konceptet bashkëkohore të menaxhimit të organizatave publike dhe jofitimprurëse; • Të aftësohen të shohin këtë lëndë si nevojë për fitimin e njohurive, të cilat do të jenë në kontekst të zbatimit në praktikë të asaj që kanë mësuar; • Të mendojnë në mënyrë efikase që do t'u ndihmojë të përballen më problemet e menaxhimit dhe sigurimit të fondeve për organizatat jofitimprurëse në jetën e tyre të mëtutjeshme.

Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studentët duhet të jenë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zbatojnë konceptet e menaxhimit në sektorin publik dhe të njohin organizimin dhe funksionimin, e organizatave publike dhe jofitimprurëse, si zbatimit të politikave, kornizës ligjore dhe të vendimmarrjes; • Hartojnë plane zhvillimore strategjike dhe të njohin menaxhimin e zhvillimit të organizatave jofitimprurëse; • Njohin burimet e të ardhurave, si dhe procedurave të përgjithshme buxhetore që duhet të ndiqen nga organizatat publike dhe jofitimprurëse; • Ndërtojë koncepte të pavarura lidhur me menaxhimin e organizatave publike dhe jofitimprurëse përmes hulumtimeve dhe përgatitjes së projekteve hulumtuese profesionale nga kjo fushë.
--	---

Rëndësia dhe aktualiteti i lëndës	<p>Menaxhimi i organizatave publike dhe atyre jofitimprurëse si lëndë ka fokus krijimin e politikave, planifikimin strategjik dhe vendimmarrjen, menaxhimin e burimeve njerëzore, menaxhimin e financave dhe buxhetin, mbikëqyrjen dhe kontrollin, sigurimin e fondeve si dhe kuadrin ligjor dhe atë fiskal që rregullon veprimtarinë e tyre.</p>
--	---

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime			
Punë praktike	2	1	2
Konsultime me mësimdhënësin	1	9	9
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	2	2	4
Detyrë shtëpie	3	1	3
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	2	5	10
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	3	2	6
Projektet, prezantimet, etj.	2	3	6
Total			100

Metodat e mësimdhënies:	<p>Procesi i mësimdhënies organizohet nëpërmjet leksioneve duke zbatuar diskutimet interaktive, ekipin e punës dhe prezantimet e seminareve nga studentët, të cilat do të diskutohen gjatë orëve mësimore.</p>
--------------------------------	--

Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i dijeve dhe aftësive të fituara bëhet përmes vijueshmërisë, aktivitetit, kollokviumit, punimit seminarik dhe provimit.</p> <p>Metodat e vlerësimit dhe kriteret kaluese:</p> <p>Pjesëmarrja aktive në klasë: 10%</p> <p>Prezantimi i projektit: 20%</p> <p>Test I: 30%;</p> <p>Test II: 40%.</p> <p><i>*Projekti është i detyrueshëm.</i></p>	
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ahmet Ceni, <i>“Menaxhimi i organizatave publike”</i>, ShBLU, Tiranë, 2011 2. Hal G. Rainey, Sergio Fernandez, Deanna Malatesta, <i>“Understanding and Managing Public Organizations (Essential Texts for Nonprofit and Public Leadership and Management)”</i>, Wiley, 2021. 3. Ligjërata të autorizuara, 2022. 	
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Theodore H. Poister, Maria P. Aristigueta, Jeremy L. Hall, <i>“Managing and Measuring Performance in Public and Nonprofit Organizations: An Integrated Approach”</i>, Jossey-Bass, 2014. 2. Nicolas A Valcik, <i>“Strategic Planning and Decision-Making for Public and Non-Profit Organizations”</i>, Routledge, 2016. 3. Joan E. Pynes, <i>“Human Resources Management for Public and Nonprofit Organizations: A Strategic Approach”</i>, Jossey-Bass, 2013. 	
Hartimi i planit mësimor		
Java	Titulli i ligjëratisë	Ushtrimet
Java 1:	Konceptet dhe parimet bashkëkohore të menaxhimit në sektorin publik	
Java 2:	Modelet e menaxhimit publik	
Java 3:	Menaxhimi i sektorit publik dhe shërbimeve publike	
Java 4:	Planifikimi strategjik në organizatat publike dhe jofitimprurëse	
Java 5:	Organizimi, funksionimi dhe proceset e vendimmarrjes në organizatat publike dhe jofitimprurëse	
Java 6:	Zhvillimi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i vullnetarëve	
Java 7:	Qeverisja korporatave	
	TESTI I	
Java 8:	Menaxhimi i financave	
Java 9:	Menaxhimi i shërbimeve në organizatat publike	
Java 10:	Udhëheqja organizative në sektorin joqeveritar	
Java 11:	Vendimmarrja në organizatat publike dhe jofitimprurëse	
Java 12:	Mbikëqyrja dhe kontrolli i organizatave publike dhe jofitimprurëse	
Java 13:	Kquadri ligjor që rregullon veprimtarinë e sektorit jo-fitimprurës dhe sigurimi i fondeve për organizatat jofitimprurëse.	

Java 14:	Projekti i ekipit/Prezantimet
Java 15:	Projekti i ekipit/Prezantimet
	TESTI II

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.

Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

Shënim | Nëse 3 detyra të klasës të një studenti vlerësohen nën 50%, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final. Vlerësimi bëhet nga 0-100 %.